



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Nr. 344 Prot

Tiranë, më 29, 10, 2014

VENDIM Nr. 350, datë 15.10.2014

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 15.10.2014, pasi shqyrtoi projektin e "Rehabilitimit të rrugës "Vrana Konti"; Ndërtimit të tualeteve publike në brëndësi të Kalasë së Krujës" si dhe disa ndërhyrje të vogla rehabilituese në peisazhin rreth tyre", paraqitur nga subjekti i licensuar "Atelier 4", financuar nga Bashkimi Europian.

VENDOSI:

- I. Të miratojë variantin me thellësi të gërmimit të themeleve të tualeteve 1.05m, në mënyrë që ndërtimi i tyre të ndikojë sa më pak në peisazhin e ambientit të Kalasë së Krujës.
- II. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja e vazhdueshme arkeologjike nga arkeologët e DRKK Durrës në bashkëpunim me arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO